

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutin Shoqërisë me nr.1861 Prot. datë 01.09.2022, Rregullorës së brendëshme të Shoqërisë, Marrveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime Dibër sha, datë 22.07.2022, shpallen procedurat e konkurimit për vend të lirë pune:

1(një) Manovrator Uji - Njësia Mat

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Manovratori i Ujit, nga ana administrative varet nga Përgjegjësi i Administratës së Njesisë përkatëse, ndërsa nga ana funksionale varet nga Drejtori i Drejtorisë Teknike.

Manovratori i Ujit ka këto detyra dhe përgjegjësi;

1. Kryen manovrimin e valvulave, hidranteve dhe pajisjeve të tjera të ujësjiellës sipas planit të punës.
2. Siguron shpërndarjen e ujit sipas skemës së furnizimit dhe monitoron funksionin normal të rrjetit.
3. Kontrollon periodikisht linjat e transimitit dhe shpërndarjes, rezervuarëve, pusetat, valvulat dhe objektet e tjera të sistemit.
4. Konstaton, evidenton dhe raporton menjëherë çdo avari, rrjedhje, dëmtim ose parregullsi të konstatuar gjatë kontrollit të rrjetit.
5. Merr pjesë në izolimin e linjave gjatë riparimeve dhe në rikthimin e tyre në funksion pas përfundimit të punimeve.
6. Bashkëpunon me hidraulikët, teknikët dhe punonjësit e tjerë në eliminimin e defekteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit.

7. Kryen kontrolle të vazhdueshme për evidentimin e humbjeve të ujit dhe informon eprorin për marrjen e masave.
8. Mban evidencë për manovrat, kontrollet dhe ndërhyrjet e kryera gjatë shërbimit.
9. Përdor dhe mirëmban me përgjegjësi mjetet e punë dhe pajisjet që i vihen në dispozicion.
10. Respekton rregullat teknike, procedurat e punë, aktet e brendshme të shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
11. Zbaton rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përdor pajisjet mbrojtëse personale.
12. Merr pjesë në shërbimet e gadishmërisë dhe ndërhyrjet emergjentensipas organizimit të punë.
13. Kryen çdo detyrë tjetër funksionale që lidhet me pozicionin e punës dhe që i ngarkohet nga eprori.

Përgjegjësitë

1. Përgjigjet për zbatimin korrekt dhe në kohë të detyrave funksionale.
2. Mban përgjegjësi për dëmet që shkaktohen si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij në kundërshtim me legjislacionin dhe sktet e brendshme të shoqërisë.
3. Përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës.
4. Respekton etikën në punë dhe ruan kofidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrës.

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Të jenë shtetas shqiptarë;
- ✓ Të kenë përfunduar arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) ose arsimin e mesëm;
- ✓ Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës;
- ✓ Eksperienca në sektorin e ujësjellësit përbën avantazh.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Curriculum Vitae (CV);
2. Fotokopje të kartës së identitetit;
3. Fotokopje të librezës së Punës (nëse disponon);
4. Çertifikatë personale;

5. Certifikatë e gjendjes familjare;
6. Diplome shkolle (e noterizuar);
7. Listë notash (e noterizuar);
8. Dokumente që vërtetojnë kualifikime ose eksperiencë pune (nëse ka);
9. Dëshmi Penaliteti;
10. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
11. Vërtetim prokurorie;
12. Saktësim adrese nga Bashkia;
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë);
14. Foto të vogla dy (2 copë), foto e madhe një (1 copë).

Kandidatet do të vleresohen mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe nevojave të institucionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara do të ftohenn për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit. Kandidati fitues do të njoftohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a sipas procedurave në fuqi.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a., brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së fituesit. Ankesa protokollohet dhe shqyrtohet nga Sektori Juridik, në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.